



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Rahovec, e mbajtur më 05.11.2021 me fillim në ora 15.30. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi. Kryetari- Më lejoni t'i përshëndes të gjithë të gjithë anëtarët e KKSBB, Nënkyretarin e komunës, Fatmir Iska, Drejtori i Drejtive, togerin e stacionit të policisë në Rahovecit z. **Bekim Vuçitërna**, Përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës prezent këtu, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjera që janë prezent në sallë. Është mbledhja e gjashë e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Përpara e keni një rend dite i cili buron nga plani vjetor i punës për vitin 2021 i cili është aprovuar edhe në Kuvendin e Komunës.. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend Dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë rrëth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19;
3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Vetëdijesimi përrrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike;
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit përsiguri në shkolla;
 - Mungesa e parkingjeve në qytet dhe ndriçimi publik;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSBB-së për vitin 2022;
5. Të Ndryshme.

Kryetari - A ka dikush të shtojë diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo atëherë e qes në votim. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

A ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo atëherë e qes në votim: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Kalomë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Informatë rrëth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19.

Kryetari – Do i japë disa informatë sa i përket situatës me Covid – 19 në Komunën e Rahovecit. Procesi i vaksinimit është duke vazhduar në komunën tonë, deri në ditën e djeshme janë vaksinuar me një dozë rrëth 45.45%, kurse me dy doza rrëth 38.20 %, nëse e llogarisim të gjithë të vaksinuarit në komunën tonë që kanë marrë si një si dy dozë janë rrëth 82.64%. me këtë ne kemi mbërrit një shkallë të imunizimit të popullsisë, pra përmes një procesi i cili ka shkuar shumë mirë. tani numri la rënë dukshëm sepse siç e thash shumica janë të vaksinuar, ne tani nuk kemi probleme me vaksina, kemi mjaftë dhe tani besoj se nuk ka nevojë që të bëhen as terminë. Rastet me covid – 19 në komunën tonë janë të pakta, edhe ata që kanë pasur shumica janë të shëruar. Komuna jonë vazhdon me testet rapide, poashtu edhe numri i të interesuarve për tu testuar është jashtëzakonisht i vogël sepse shumica e qytetarëve siç e thamë janë të vaksinuar. Ju bëjë thirrje nga ky tubim qytetarëve që kush ka mbetur pa u vaksinuar le të shkojë ta kryej obligimin, kurse ata që nuk kanë

mundësi shëndetësore që të shkojnë në QKMF për tu vaksinuar, ne kemi ekipet mobile dhe ata munden të shkon nëpër shtëpi të u japid vaksinat. Masat anti covid me vije mirë që në këto zgjedhje janë respektuar më shumë se në zgjedhjet e shkurtit, në këto zgjedhje secili subjekt politik është kujdesur që të respektohen sa ma shumë masat anti – covid. Poashtu lusë qytetarët që të respektojnë edhe orën policore, pra neve na mbetet që ta respektojmë vendimin e qeverisë deri sa ky vendim të jetë në fuqi. Për më shumë e hapi debatin.

Ramë Berisha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pandemia është dukuri botërore, por ne duhet të i përbahemi rekomandimeve të udhëheqësve tanë, mjekëve etj. me zbulimin e vaksinës shumica e popullatës janë vaksinuar, mendoj se tani virusi është duke humbur efikasitetin e tije në vendin tonë.

Lendrit Qeli – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndajë një informatë sa i përket menaxhimit të pandemisë, organizata Ballkan son flavors, së bashku me DSHPS dhe bashkëpunëtor të tjera, jemi duke i ndihmuar që pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, në ngritjen e vetëdijes për vaksinim. Ne kemi parë që shumica kanë hezituar që të vaksinohen, falë kësaj mbështetje diku rrëth 60 % të tyre kanë arritur që të marrin dozën e parë, ne jemi duke vazhduar edhe më tutje që të mundet të vaksinohet secili prej tyre.

Kryetari – A ka dikush tjetër të shtoj diçka sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës, nëse jo atëherë kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit. Kemi edhe disa nën pika sa i përket kësaj pike ti cilat duhet diskutuar, disa nën pika nuk janë ndoshta shumë aktuale, por ne jemi duke vepruar sipas planit të punë ssë KKSBB-së. Sipas gjitha informatave dhe burimeve që i kemi, gjendja në komunën e Rahovecit vazhdon të jetë e qetë dhe stabile, me disa incidente të vogla. Sa i përket problemeve ndëretnike nuk kemi pasur, ndonjë rast të raportuar sa i përket problemeve ndëretnike. Por kjo nuk do të thotë që ne në komunën tonë nuk kemi angazhime, ngjarje, delikuanca, incidente, kundërvajtje, vepra penale të vogla. Për më shumë fjalën ja kisha dhënë komandantit të policisë z. Fazli Morinës.

Fazli Morina - Komandant i stacionit policor – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do e paraqes një raportë të shkurtër, në mënyre që mos të zgjerohemi shumë, por do i cekim disa gjera që ja vlen të ceken. Sa i përket situatës së sigurisë e ceku edhe kryetari. Situata është e qetë dhe stabile. Kurse sa i përket menaxhimit të situatës me pandeminë Covid – 19, Policia e Kosovës është angazhuar duke punuar me orar rregullt dhe sipas nevojës edhe me orar te zgjatur 12 orësh, ku janë përfshire të gjitha njësitet e S.P. Rahovec, kohë pas kohe sipas nevojës të asistuar edhe nga njësita te specializuara DRP-se Gjakove si: NJSRH-se, NJSO-se dhe NJRKRR-se të cilët janë te angazhuara në implementimin e Planit Operativ të DRP-se Gjakove „Për Gatishmëri dhe Reagim për Corona Virus COVID-19”, duke vepruar në përputhje më vendimet e Qeverise dhe zhvillimeve tjera aktuale, për menaxhimin e situatës se pandemisë, në tëre territorin e komunës se Rahovecit. Po ashtu patrullat tona kane asistuar dhe vazhdojnë te asistojnë Inspektoret Sanitar, AVUK dhe atyre komunal duke bashkëvepruar sipas kërkesave dhe nevojave ne teren, për menaxhimin e situatës se pandemisë Covid-19. Në kuadër të këtij plani, gjatë periudhës raportuese, S.P Rahovec gjatë aktiviteteve policore janë shqiptuar gjobat si ne vijim: 1100 gjoba bazuar në Ligjin NR 07/L-006, për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, prej tyre: 974 gjoba për mos vendosjen e maskës mbrojtëse, 120 gjoba për mos respektim te orarit te lëvizjes dhe 6 gjoba për organizime-ahengje te ndaluara. Aktivitet tjetër i rëndësishëm ka qenë edhe mbajtja e zgjedhjeve lokale me datë 17.10.2021, këto zgjedhja janë zhvilluar dhe kanë përfunduar pa asnjë incident. Tubime politike të paraqitura në stacion tek ne gjithsej kanë qenë 57, nga këto janë mbajtur vetëm 46, kurse 11 tjera janë anuluar për arsyet e ndryshme.

Veprat Penale të iniciuara tek stacioni policor në Rahovec - Gjatë kësaj periudhe, ne S.P. Rahovec janë regjistruar gjithsejtë: 108 Raste, prej tyre 104 vepra penale dhe 5 incidente të ndryshme. Nga këto raste mund të veçojmë disa vepra më të renda: vjedhje: 6 raste, vjedhje të rënda: 23 raste, dhunë në familje: 6 raste. Lidhur me rastet e cekura, nga njësitet kompetente në kuadër të stacionit policor në Rahovec dhe Hetimeve Rajonale ne Gjakove, janë ndërmarr të gjitha veprime e nevojshme.

Siguria në komunikacionin rrugor - Policia e Kosovës në vazhdimësi ndërmerr masat e nevojshme për ngritjen e sigurisë në komunikacion, për të mundësuar dhe përmirësuar lëvizjen e lirë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion rrugor.

Nga S.P Rahovec është duke u implementuar P.O “Siguria në trafikun rrugor 2021”, ku ne kuadër te këtij plani gjate periudhës raportuese nga patrullat policore te S.P Rahovec, janë shënuar: 867 kundërvajtje, prej tyre 8 kundërvajtje për PRQP.

Siguria në Shkolla - Policia e Kosovës në vazhdimi është e përkushtuar lidhur me sigurinë në objektet shkolllore, ku gjate periudhës raportuese, janë bëre vizitat ne shkolla dhe kontaktet me kuadrin arsimor, njëkohësisht edhe pika te kontrollit afër shkollave te zonës tone te përgjegjësisë. Me fillim te procesit mësimor vazhdon implementimi i Planit Operativ “Siguria në Shkolla” 2021/2022, duke ndërmarr masat e sigurisë me aktivitetet te planifikuara policore. Sa i përket rasteve ne shkolla, gjate përudhesh raportuese, ne shkollat e zonës tone te përgjegjësisë, janë raportuar: 4 raste (3 Lëndime trupore, 1 Asgjësim-dëmtim prone).

Bujar Morina – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket pikës rreth komunikacionit, rruga e plantazhit Sopniq – Ratkoc – Xërxe - e cila është shtruar tani në kohën e fundit, poashtu është bëre edhe shenjëzimi i kësaj rruge. Këto shenja gati për çdo ditë janë duke u rrezzuar ose lëvizur nga vendet ku janë vendlodhur, arsyeta e zhvendosjes së tyre mendoj unë se është mos betonimi i mirë nga ana e kompanisë. Punojë në kompaninë e Stone Castle, thuajse çdo ditë i rregullojmë këtë shenja të komunikacionit, nuk e di a rrëzohen vetë apo dikush me qëllim është duke e bërë. Gjithashu e kisha latur komandantin e policisë që të dërgoj ndonjë herë patrullën e policisë në atë rrugë sepse janë duke i dhanë shumë shpejtë makinat, kurse rruga nuk është rrugë standarde që të shkohet me atë shpejtësi.

Shaip Shala – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, fjala ime do të jetë vazhdimi i diskutimit ose shqetësimit të mbledhjes së kaluar, që ka të bëjë me sjelljen e disa shikuesve. Javën e kaluar kemi pasur dy ndeshje të ndërprerë në palestër me nga 10 minuta për arsyet e këtyre tifozëve, për mua nuk janë ata tifoz, por nxitës dhe përçarës. Prandaj kisha kërkuar si anëtar i KKSBB-së që këta tifozë të përcillen pak më mirë nga organet e rendit. Nëse e kemi një ndeshje të nxehjtë dhe besoj se kishte me qenë mirë që ata tifoz të jenë në fokus të organet e rendit. Këtë shqetësim që po e ndaj me ju, e ndajë për hire të sportit, për hire të kulturës Rahoveciane dhe imazhit të qytetit etj. pra mos të lejojmë që një grusht njerizosh të na prishin atmosferën e lojës.

Nysret Abazibra – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, desha ta ndajë me ju një informatë, poashtu ta ngrisë edhe një shqetësim. Në këtë dy javët e fundit na kanë ndodhur disa veprime të cilët na kanë dëmtuar si institucion, duke filluar nga 15 tetori deri me 30 tetor, kemi pasur thyerje të arkave bamirëse në 3 xhami, ajo që është më shqetësuese është se në një xhami ka ndodhur dy herë brenda kësaj periudhe. Ne i kemi kamerat e vendosura në çdo xhami, por hajnat nuk po vërehen për arsyet e maskimit, tani edhe me maska kundra Covid – 19 dhe kapela. Ky dëmtim nuk është shumë i madhe nëse e marrim në aspektin material sepse ato arka humanitare janë që mblidhen kohë javore, aty munden me qenë deri në 100 €, ne as vetë nuk e dimë se sa kanë mundur me qene. Por shqetësimi më shumë ka të bëjë me siguri, ne tani nuk po ndihemi të sigurte sepse mundet të ketë edhe veprime të tjera dhe në këtë rast është përhapur një farë panike. Dje jam njoftuar nëpërmes fëmijëve sepse i pash edhe ata të traumatizuar, kishin hyrë hajnat dhe kishin vjedhur naftë. Ky është edhe një lëshim nga menaxhmenti i shkollës sepse nuk duhet të i tregohen këto gjëra fëmijëve, kjo ishte nga unë si informatë dhe shqetësim dhe besoj se organet tona të ndërmarrin masa.

Fazli Morina – Sa i përket rastit të huliganizmit nga tifozët nëpër salsa sportive që e potencoj Shaip Shala, në formë indirekte e kam dëgjuar këtë problem. Sipas informatave që i kemi numri i atyre individëve që shkon jo më shumë se 5 veta, njihet edhe nga ekipe që janë të regjistruara në komunën tonë. Nuk është në kompetencat tona që ne atyre të ja ndalojmë hyrjen përderisa ata vinë tek dera me biletë në dorë. Nëse klubet i njojin dhe këta persona ja humbin imazhin e klubeve, është plotësisht kompetencë juaja që të ndërmerrni masa që të ja ndalon hyrjen në sallë. Ose le të vinë tek ne le të paraqesin një ankesë, pastaj ne i ndërmarrim veprimet tona, kjo është ajo që mundemi ne të bëjmë.

Sa i përket vjedhjeve nëpër xhami në Rahovec, na janë paraqitur katër raste dhe të gjitha këto raste janë ditëve të fundit. Para pak dite ka pasur edhe 3 raste në Gjakovë, përfatë të mirë rastet në Gjakovë janë zbardhur është arrestuar kryesi i atyre veprave penale dhe vazhdohet me procedurat e mëtutjeshme. Ajo që dua të them është se nuk ka ngecje as nga ana jonë sa i përket rasteve që kanë ndodhur në xhemit e Rahovecit, jemi në pistë të mirë të hetimit ne do të bëjmë të pamundurën që ta zbardhim rastin.

Kryetari – Po i përgjigjëm Bujarit, i nderuar është e vërtet se ato shenja që janë të vendosura në atë rrugë, nuk mendoj që dikush pa qëllim është duke i dëmtuar, mundet të ndodhë që të ketë pasur edhe ndonjë aksident, por është hera e dytë ose e tretë që ato shenja janë duke u hekur nga vendi. Poashtu jam dakord me atë që një shenjë është prerë nga dora e njeriut në rrugën ku ndahet përfshatin Sopniq, mendoj se është rrrezik i përgjithshëm nëse nuk janë shenjat e vendosura aty ku duhet të jenë përsye se rruga ka kthese dhe është bërë një rrugë shumë e qarkullueshme. Kurse sa i përket shqetësimit të Shaipit, pajtona poashtu me përgjigjen që ja dha komandanti. Por edhe ne duhet të jemi pak më të përmbajtur sepse sporti në përgjithësi e ka një farë stresi ose mbingarkese dhe kjo është shumë normale, por është mirë që mos ti i frymë zjarrit, sepse nuk është pamje e mirë besoj si për ne ashtu edhe përsportin që të ndërhyj njësia speciale. Poashtu edhe këto mediat sportive i kisha bërë apel që mos ti frynë zjarrit, portalet tona si të Suharekës ashtu edhe të Rahovecit e kanë bërë që të acarohet situata në mes tifozëve të Rahovecit dhe Suharekës në basketboll. Kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSBB-së për vitin 2022.

Kryetari - Besoj se plani është bukur mirë i përgatitur, a keni ju ndonjë propozim, ndonjë plotësim sa i përket pikave të rendit të ditës, nëse jo unë e kisha hedhë në votim Planin e KKSBB-së për vitin 2022. Desha të ju njoftoj se ky plan pas aprovimit nga ana e juaj do të votohet në kuvend. E qes në votim: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar Plani i Punës së KKSBB-së për vitin 2022. Kalojmë në pikën e fundit:

5. Të ndryshme.

Kryetari – A ka dikush të shfojë diçka sa i përket kësaj pike.

Shani Hoti – Përshtendje për të gjithë të pranishmit, desha të ndajë një informatë me ju, si KLSB sektori C, dje kemi arritur që ta përfundojmë projektin e radhës pajisja e kabinetit informatikë në shkollën "Skender Kastrati", me 11 lloaptop dhe 2 videoprojktor, për këtë projekt falënderoj OSBE-në. Poashtu falënderoj për bashkëpunim rreshterin z. Avni Paqarizi dhe anëtarët e komunitetit lokal përsiguri në bashkësi. Falënderim të veganrt edhe për ju z. Kryetar sepse po jeni të gatshëm në çdo projekt që na paraqitet dhe që kërkohet mbëshitetje nga ana e juaj ju nuk na refuzoni por na keni aprovuar kërkesën tonë.

Kryetari – Isha edhe unë prezent në këtë aktivitet ku ishte fituar një donacion përkabinetin e informatikës vepër e KLSP-së në bashkëpunim me OSBE-në, ne i inkurajojmë si juve z. Shani edhe të tjerët që të i sjellin sa më shumë të mira Komunës së Rahovecit, sepse është nder dhe detyrë që të punojmë që të kemi sa më shumë zhvillime pozitive në Rahovec.

Përfundë falënderoj secilin anëtar të KKSBB-së në këtë legjislaturre, posaçërisht atyre që kanë mbajtur barrën më të madhe si policisë dhe institucionet që janë ballafaquar me gjithë atë që jemi përballur si komunë në këto katër vite, në mënyrë që komuna jonë të jetë e qetë dhe stabile.

Mbledhja përfundoj në ora 17.15

Procesmbajtësi

Skender Hamza



Kryetar i Komunës

Smajl Latifi